

**Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit**


Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike, në nivel qendror, përgjegjëse për hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit në Shqipëri.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton dhe ndjek kuadrin strategjik kundër korrupsionit, përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të integritetit, politikave dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe të edukimit kundër korrupsionit. Është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve publike që kryejnë abuzime me detyrën. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon mekanizmin e referimit, të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Buletini elektronik është një mjet komunikimi që synon të informojë aktivitetet kryesore, iniciativat dhe zhvillimet në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një përmbledhje mujore të punës së institucionit.

**Aktivitetet përgjatë muajit maj, 2026****Prezantohen angazhimet antikorrupsion të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, 2026-2030**

**19.05.2026:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përfundoi procesin e bashkë-hartimit të angazhimeve në fushën e luftës kundër korrupsionit, në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur, 2026-2030. Në një takim online me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike të përfshira në proces, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezantoi tre angazhimet e propozuara, të hartuara përmes një procesi konsultues dhe bashkëpunues me grupet e interesit. Angazhimet fokusohen në zgjerimin e instrumenteve parandaluese të korrupsionit përmes vlerësimit sistematik të riskut të korrupsionit (1), promovimin e transparencës dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendimmarrjen publike (2), si dhe përfshirjen dhe zhvillimin e tematikave të integritetit në kurrikulën e arsimit parauniversitar (3). Në total, angazhimet e propozuara përfshijnë 22 masa konkrete me pjesëmarrjen e institucioneve të pushtetit ekzekutiv, institucioneve kushtetuese dhe të pavarura, si dhe ndërmarrjeve publike. Gjatë takimit u diskutuan hapat e mëtejshëm për finalizimin e Planit Kombëtar të Veprimit dhe rëndësia e vijimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile edhe në fazën e zbatimit dhe monitorimit të angazhimeve.

**DPAK dhe AMVV bashkëpunojnë për hartimin e "Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetqeverisjes Vendore"**

**11.05.2026:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit dhe Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore bashkojnë ekspertizën teknike për hartimin e "Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore". Me urdhër të përbashkët të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, është ngritur grupi i punës që do hartojë dokumentin, i cili do të udhëzojë vlerësimin e riskut të integritetit në bashki dhe qarqe. Për këtë qëllim u zhvillua takimi i parë i punës, që shënoi nisjen e procesit për hartimin e një metodologjie të standardizuar që do të mbështesë njësitë e vetëqeverisjes vendore në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit, si dhe në planifikimin e masave për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional. Gjatë takimit u diskutuan fushat dhe proceset me risk në nivel vendor, gjetjet dhe rekomandimet e raporteve ekzistuese, si dhe qasja metodologjike që do të ndiqet për hartimin e dokumentit. Anëtarët e grupit të punës, dakordësuan vijimin e punës mbi faktorët bazë të riskut të integritetit, hartimin e kalendarit të punës dhe përfshirjen e ekspertizës përkatëse në procesin e konsultimit të draftit. Metodologjia pritet të kontribuojë në forcimin e mekanizmave të integritetit dhe rritjen e kapaciteteve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për menaxhimin e risqeve të integritetit dhe parandalimin e korrupsionit. Metodologjia do të mbështetet nga asistenca teknike e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me ambasadën e Zvicrës në Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit procedon 7 masa administrative dhe 6 rekomandime për përmirësim procedurash ndaj zyrtarëve të administratës publike

**1-29.05.2026:** Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ vijon me verifikimin e rasteve (ankesa/denoncime) të përcjella nga qytetarët dhe Koordinatorët Kundër Korrupsionit. Gjatë muajit maj 2026, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka konkluduar 2 raporte përfundimtare nëpërmjet të cilëve ka propozuar 7 masa administrative dhe 6 rekomandime për punonjës të autoriteteve publike ku ushtron funksionet e koordinatorit antikorrupsion. Këto masa janë adresuar kryesisht për punonjës të Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. 2 nga masat administrative janë propozuar për drejtuesin aktual të institucionit dhe ish-drejtesin e tij. Ndërkohë, rekomandimet adresojnë çështje të natyrës administrative dhe kanë patur në fokus kryesisht përmirësimin e zbatimit të ligjit, rishikimin dhe përditësimin e kuadrit rregullator të brendshëm, garantimin e ofrimit të shërbimeve publike brenda afateve ligjore, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe publikun.

**Raportoni raste të korrupsionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në adresë:** [koordinatori.ak@dpak.gov.al](mailto:koordinatori.ak@dpak.gov.al)

**Nga politikat në zbatim: nis nga zbatimi projekti "GoEthics 2.0"**

**6.05.2026:** Nis nga zbatimi projekti "GoEthics 2.0", një nismë e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në partneritet të ngushtë me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Takimi i prezantimit të projektit mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, partnerëve ndërkombëtarë dhe organizatave të shoqërisë civile për të diskutuar mbi sfidat dhe mundësitë për forcimin e integritetit institucional dhe qeverisjes etike në sektorin publik. Në fokus të diskutimeve ishte rëndësia e kalimit nga politikat në zbatim, përmes përdorimit të instrumenteve të integritetit dhe forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe llogaridhënies. Projekti "GoEthics 2.0" synon të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit në institucionet e: INSTAT, Autoritetin e Konkurrencës, Agjencinë e Prokurimit Publik, ATRAKO, Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, Postën Shqiptare dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, organeve mbikëqyrëse dhe shoqërisë civile, projekti synon të kontribuojë në rritjen e transparencës, forcimin e integritetit institucional dhe besimit të publikut në administratën publike. "GoEthics 2.0" realizohet me mbështetjen financiare të Ambasadës së Suedisë në Shqipëri.

**Forcimi i kulturës së ligjshmërisë tek të rinjtë; orë e hapur informative në shkollën "Ali Demi", Vlorë**

**19.05.2026:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit përmbylli me sukses projektin tre-vjeçar "Edukimi kundër korrupsionit", të zbatuar në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministrisë së Arsimit dhe Ambasadës së Italisë në Shqipëri. "Edukimi kundër korrupsionit" mundësoi promovimin e kulturës së ligjshmërisë dhe qytetarisë së përgjegjshme për parandalimin e korrupsionit, për nxënësit e klasave të X-ta. Aktivitetet dhe orët informuese u mbyllën në qytetin e Vlorës, me zhvillimin e një ore të hapur mësimore në shkollën "Ali Demi". Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit u trajtuan tema që lidhen me integritetin, etikën, respektimin e rregullave dhe përgjegjësinë qytetare, duke theksuar rëndësinë e edukimit të hershëm në formimin e qytetarëve të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar. Përmes diskutimeve interaktive, shembujve praktikë dhe shkëmbimit të ideve, nxënësit u nxitën të reflektojnë në promovimin e ndershmërisë, integritetit dhe reagimit qytetar ndaj fenomeneve që cenojnë besimin publik dhe vlerat demokratike.

